



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.97 dt.17.06.1997

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.17.06.1997, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndërtim Strehimit “Propozim për kalim në fond banese të disa objekteve”, bazuar në Ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, si dhe të V.K.M. me Nr. 153, dt.03.04.1993 ”Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”

VENDOSI

1. Të miratojë kalimin në fond banese në dispozicion të Bashkisë Tiranë, objektin “Hotel i punëtorëve” e ish N.N.I.Elbasani që ndodhet në Qytetin e nxënësave.
2. Të miratojë kalimin në fond banese në dispozicion të Bashkisë së Tiranës, objektin godinë tre katëshe e ish shkollës së ulët të ndërtimit, që ndodhet në qytetin e nxënësave.
3. Të miratojë kalimin në fond banese në dispozicion të Bashkisë së Tiranës, objektin godinë dy katëshe e ish shkollës së mesme bujqësore, që ndodhet në qytetin e nxënësave.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Ndërtim Strehimit në Bashkinë e Tiranës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

